REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS
KËSHILLI BASHKIAK

Komisioni Ekonomisë dhe Shërbimeve Sociale
të Këshillit Bashkiak Has

RAPORT VENDIMMARRJE
Nr. 11 datë 03/09 2025

Lenda: **Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit per Planin e Menaxhimit Pyjeve**

Komisioni i Bujqësisë dhe Pyjeve të Këshillit Bashkiak Has, në mbledhjen e tij, shqyrtoi dhe Analizoi Planin e Menaxhimit të Pyjeve të Bashkisë Has për periudhën afatmesme dhe afatgjatë Pas shqyrtimit të dokumentacionit teknik dhe bazës ligjore, komisioni vlerëson rëndësinë e këtij plani si një instrument thelbësor për administrimin e qëndrueshëm të burimeve pyjore të bashkisë.

Baza Ligjore

- Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore";
- Ligji nr. 57/2020 "Për pyjet" dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 437, datë 20.07.2016, "Për miratimin e rregullores për hartimin e planeve të menaxhimit të pyjeve";
- Strategjia Kombëtare për Zhvillimin dhe Mbrojtjen e Pyjeve;
- Direktivave dhe standardeve të Bashkimit Evropian për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve.

Përfundime dhe Rekomandime

Komisioni i Bujqësisë dhe Pyjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin teknik dhe ligjor, arrin ne përfundimin se Plani i Menaxhimit të Pyjeve është një domosdoshmëri për administrimin e qëndrueshëm të pyjeve të Bashkisë Has. Ky plan siguron një qasje afatgjatë, të strukturuar dhe të qëndrueshme për ruajtjen e ekosistemeve pyjore dhe zhvillimin ekonomik vendor.

Në këtë kuadër, Komisioni i Bujqësisë dhe Pyjeve, pas degjese publike qe u organizua, sipas ligjit per kete plan, i propozon Këshillit Bashkiak Has miratimin në tërësi të Planit të Menaxhimit të Pyjeve.

Kryetari i Komisionit të Bujqësisë dhe Pyjeve: _____

Anëtarët e Komisionit: _____